



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA EKONOMISE DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE " KOLE MARGJINI " SHKODËR**

Nr 152 prot

Shkodër 18 .09. 2026

Lënda: Njoftim për shpallje vendi të lirë pune

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr. 15/2017, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e realizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", udhëzimin nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar. Shkolla Profesionale "Kolë Margjini", ju njofton krijimin e një vendi të lirë pune për pozicionin:

Përgjegjës Sektori Finance dhe Administrimi, me kohë të plotë, 1 (një) person:

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës.

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.

Të mos ketë masa disiplinore që nuk janë shuar.

Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit.

Të demonstrojë aftësi në punë, në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

Të ketë diplomë universitare të nivelit "master i shkencave" (ose i barasvlefshëm) në shkencat ekonomike.

Të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë në profesion sipas përcaktimeve në pozicionin e punës.

Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit:

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, të përfshijë:

Letër motivimi për pozicionin.

Jetëshkrimin (CV-në).

Kartën e identitetit.

Diplomën.

Librezën e punës.

Çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.

Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.

Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.

Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi i mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

1- Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës --25.09.2026
-----09.2026.

2- Vlerësimi i kandidateve do të bëhet referuar përcaktimit të Udhëzimit nr. 759, datë 27.05.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, për bërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

